



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **E Drejta Kushtetuese (2026/2027)**

Fakulteti	Drejtësia
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	60
Kodi	CAL60
Titulli	Magjistër i shkencave juridike - Drejtimi: E drejta kushtetuese
Data akreditimit	07.02.2025

Përshkrimi i programit

Programi i studimit është i harmonizuar me tendencat bashkëkohore globale dhe evropiane dhe është i krahasueshëm me programe të ngjashme në institucionet e huaja të arsimit të lartë, veçanërisht në hapësirën arsimore evropiane. Qëllimi është përgatitja e juristëve të kualifikuar përmes studimeve dhe hulumtimeve moderne shkencore që kontribuojnë në formësimin e politikave juridike dhe funksionimin e sistemit juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe më gjerë. Programi i studimit është krijuar për t'u ofruar studentëve një njohje të avancuar me zhvillimet më të fundit në fushën e së drejtës kushtetuese dhe administrative. Studentëve u jepet mundësia të demonstrojnë kompetencat, njohuritë dhe aftësitë e tyre kërkimore përmes seminareve, projekteve kërkimore dhe punës praktike, si dhe duke përgatitur tezat e magistraturës. Qëllimi është përgatitja e studentëve për të kontribuar në mënyrë konstruktive në çështjet ligjore në ndjekjen e aktiviteteve të tyre profesionale në shoqëri. Programi i studimit inkurajon inovacionin brenda kuadrit të tij si dhe mbështet kërkimin shkencor, në mënyrë që t'u mundësojë studentëve të zhvillojnë dhe avancojnë njohuritë, aftësitë dhe dijet e nevojshme për t'u bërë juristë të specializuar në këtë fushë. Programi i studimit synon gjithashtu t'u mundësojë studentëve interpretimin e drejtë të Kushtetutës dhe akteve të tjera ligjore dhe zbatimin e dispozitave kushtetuese, ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme gjatë kryerjes së funksioneve publike, veprimtarive administrative apo menaxhimit të institucioneve dhe organeve të tjera publike në fushën administrative. Misioni i këtij programi studimor është avancimi i njohurive dhe aftësive të studentëve në fushën kushtetuese-administrative, si dhe forcimi i mëtejshëm i aftësive praktike në interpretimin e kushtetutës dhe mbrojtjen kushtetuese të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit në kontekstin vendas, evropian dhe ndërkombëtar. Vëmendje e veçantë i kushtohet aftësive praktike në drejtësinë administrative, e cila është një dimension mjaft kompleks, por i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave individuale dhe sundimit të së drejtës si vlerë themelore e rendit kushtetues.

Karriera

Diploma e Fakultetit të Drejtësisë njihet nga Oda e Avokatëve dhe e Noterëve në RMV. Titujt profesionalë të avokatëve dhe noterëve kërkojnë regjistrim formal në këto oda. Diploma e Fakultetit Juridik u mundëson studentëve një qasje relevante në organet shtetërore, sidomos në organet gjyqësore dhe të drejtësisë si: gjykatat dhe prokuroritë publike. Fakulteti Juridik ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë për Trajnimin e Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë në RMV. Studentëve, që do të kenë ambicie të merren me punë hulumtuese shkencore, Fakulteti Juridik i UEJL-së, u mundëson vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë (studime të doktoratës).

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Tregon njohuri dhe kuptim për të drejtën kushtetuese dhe të drejtën administrative, duke zbatuar metodologjinë adekuate për zgjidhjen e problemeve komplekse kushtetuese dhe administrative, si në mënyrë sistematike, ashtu edhe në mënyrë kreative, që siguron bazë, apo mundësi për origjinalitet në zhvillimin dhe/ose zbatimin e ideve autonome në kontekst të hulumtimit kushtetues e administrativ;
- Aftësi për përdorimin e dijeve të gjera dhe të thella kushtetuese-administrative;
- Tregon nivel të lartë të kompetencës në të drejtën kushtetuese-administrative;
- Posedon dije nga njëra ose më shumë lëndë të lëmisë, të cilat, në fushat e dhëna shkencore, mbështeten në hulumtimet më me renome ndërkombëtare në lëminë kushtetuese-administrative.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Aftësi për zgjidhjen kritike, të pavarur dhe kreative të problemeve me origjinalitet të caktuar në mjedise të reja ose të panjohura dhe në kontekst multidisiplinar, të ndërlidhur me trendet bashkëkohore të së drejtës kushtetuese dhe administrative.

Aftësitë për të vlerësuar

- Aftësi për sintetizimin dhe integrimin e dijeve;
- Aftësi për menaxhimin me çështje komplekse, sistematikisht dhe në mënyrë kreative, për vlerësimin solid, madje edhe gjatë informacioneve jo të plota dhe të kufizuara, por të cilët i përfshijnë përgjegjësitë personale, shoqërore dhe etike gjatë zbatimit të dijeve të fituara kushtetuese dhe administrative;
- Aftësi për vlerësimin dhe seleksionimin e teorive shkencore, metodologjive, mjeteve dhe shkathtësive të përgjithshme nga lëmitë e lëndëve dhe vendosja e analizave dhe zgjidhjeve të reja në baza shkencore.

Aftësitë e komunikimit

- Aftësi për këmbimin e konkluzioneve dhe propozimeve me mbështetjen me argumente dhe me mbështetje racionale të tyre, si me persona profesionistë, ashtu edhe me persona joprofesionistë, qartë dhe bindshëm;
- Marrja e përgjegjësisë së konsiderueshme për rezultatet e përbashkëta; menaxhimi dhe inicimi i aktiviteteve.

Aftësitë e të mësuarit

- Aftësi për njohjen e nevojës personale për dijet e mëtejshme dhe aftësi për veprimin e pavarur dhe të mëvetësishëm gjatë fitimit të dijeve dhe shkathtësive të reja në kontekst nacional, rajonal dhe evropian si dhe në kontekst botëror;
- Aftësi për marrjen e përgjegjësisë për zhvillimin dhe perfeksionimin e mëtejshëm profesional.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [MCAL-0101] [6.0 SETK] **E drejta kushtetuese e zbatuar**
- [MCAL-0102] [6.0 SETK] **E drejta administrative e zbatuar**
- [CM165] [6.0 SETK] **Konflikti administrativ dhe gjyqësori administrativ**
- [MCAL-0201] [6.0 SETK] **E drejta procedurale administrative**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 2

- [MCCR1120] [6.0 SETK] **Metodologjia e Hulumtimit**
- [CM256] [24.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**

Description of courses

Lëndë obligative

- **E drejta kushtetuese e zbatuar**
Përvetësimi i njohurive për konceptet, dukuritë dhe institutet e së drejtës kushtetuese si dhe për institucionet

shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë qëndrime të ndryshme teorike për to. Marrja e njohurive specifike për të drejtën kushtetuese si shkencë dhe degë e së drejtës, duke përfshirë një analizë krahasuese të situatës dhe perspektivave brenda kornizave rajonale dhe evropiane. Përmes këtij moduli studentët do të pajisen me njohuri themelore teorike dhe praktike për organizimin e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit. Nxitja e të menduarit kritik tek studentët për problemet themelore të rregullimit kushtetues në RMV dhe brenda BE-së, duke marrë parasysh profilin e juristit evropian i cili në të ardhmen si ekspert do të ketë nevojë të interpretojë dhe zbatojë të drejtën kushtetuese evropiane si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë evropian. Kurrikula do të trajtojë çështjet kushtetuese nga një këndvështrim krahasues dhe kombëtar, sepse në kontekstin e globalizimit, e drejta kushtetuese nuk mund të kuptohet nëse konsiderohet ekskluzivisht brenda kornizave kombëtare. Plan-programi do të përfshijë: Rregulloren e re të Kuvendit të RMV-së, e cila ka rol kyç në zhvillimin e demokracisë parlamentare në RMV, ligjet e reja që rregullojnë çështjet kushtetuese, si: ligjet nga fusha e gjyqësorit, vetëqeverisjes lokale, sistemit zgjedhor, shoqërisë civile, mbrojtjes, politikës së jashtme etj. Krahas kësaj komponente normative, planprogrami do të trajtojë edhe praktikën e organeve qendrore të pushtetit shtetëror në RMV, përkatësisht; Parlamenti, Qeveria, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, e cila ka një rol të madh në të drejtën kushtetuese si shkencë. Do të trajtohen ndryshimet kushtetuese të vitit 2001, të cilat kanë ndikim të madh në demokracinë shumicë në Republikën e Maqedonisë dhe në vlerat themelore të rendit kushtetues të RMV, si dhe amendamentet kushtetuese të vitit 2005 lidhur me reformat në drejtësi në RMV. Në fund të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: të bëjnë dallimet themelore dhe thelbësore ndërmjet institucioneve kushtetuese, ndërlihdjeve të tyre dhe funksionimit praktik të tyre; të bëjnë dallimet e nevojshme teorike dhe praktike ndërmjet koncepteve, dukurive dhe instituteve të së drejtës kushtetuese; të shpjegojë dhe analizojë proceset e ndryshme në sistemin dhe rendin kushtetues të Republikës së Maqedonisë në të gjitha aspektet e jetës kushtetuese të vendit, duke nënkuptuar individin, qytetarin, shtetin dhe bashkësitë etnike.

- **E drejta administrative e zbatuar**

Qëllimi i programit të studimit është që studentët të: - Përcaktojnë dhe kuptojnë termit administrim dhe funksion administrativ; - Të njohin dhe të analizojnë rregulloret ligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e administratës publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut; - Të kuptojnë aktivitetet bazë të funksionit administrativ; - Të dallojnë llojet e akteve administrative dhe të zotërojnë hapat e parë në krijimin e akteve të tilla; - Studimi i llojeve të mbikëqyrjes administrative; - Të kuptojnë mekanizmat e kontrollit mbi administratën dhe përgjegjësinë e saj përpara organeve të tjera shtetërore, por edhe para klientëve-përdoruesve të shërbimeve të saj; - Për punësime të ardhshme në organet e administratës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, organizatat joqeveritare, institucionet dhe të gjitha institucionet në të cilat zgjidhen rastet e karakterit administrativo-juridik.

- **Konflikti administrativ dhe gjyqësori administrativ**

Lënda synon t'u ofrojë studentëve të drejtësisë njohuri teorike dhe praktike juridike lidhur me: - Përdorimi i drejtë (leximi dhe interpretimi) i normave juridike që rregullojnë mbarëvajtjen (fillimin, rrjedhën dhe përfundimin) e procedurave administrativo-gjyqësore pranë Gjykatës Administrative dhe asaj të Lartë (për të gjitha profilet e avokatëve); - Përgatitja e padive për fillimin e procedimit administrativo-gjyqësor (për avokatët dhe gjyqtarët e Gjykatës Administrative); - Ndërmarrja e veprimeve procedurale gjatë procedurës administrativo-gjyqësore (për avokatët, nëpunësit civilë që zgjidhin çështje administrative, avokatët e punësuar në organet rregullatorë dhe në organet e pavarura shtetërore, gjyqtarët e Gjykatës Administrative, si dhe për shërbimet profesionale në Gjykatën Administrative); - Shkrimi i vendimeve (vendimeve dhe aktgjykimeve) të miratuara në procedurën administrative të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë (për gjyqtarët në Gjykatën Administrative); - Shkrimi i ankesave dhe padive për rinovimin e procedurave gjyqësore (për avokatët, nëpunësit civilë që vendosin çështje administrative).

- **E drejta procedurale administrative**

Qëllimi i lëndës: E Drejta e Procedurës Administrative përfshinë dy fusha (pjesë) të veçanta, si: procedurën administrative dhe konfliktin (kontestin) administrativ, që përbëjnë objektin themelor të studimit të pjesës formale (procedurale) të së drejtës administrative. Shtjellimi i lëndës iu mundëson studentëve fitimin e njohurive që më lehtë t'i kuptojnë, shpjegojnë dhe analizojnë çështjet që kanë të bëjnë me nocionet dhe institutet e së drejtës administrative procedurale. Në pjesën e parë, do të shpjegohet procedimi (veprimi), i organeve të administratës shtetërore dhe publike në zbatimin e normave juridike-materiale, kur duke aplikuar drejtpërdrejtë dispozitat juridike në raste konkrete vendosin mbi të drejtat, detyrimet, ose interesat juridike të individëve, të personave juridikë ose të palëve të tjera. Në pjesën e dytë, do të shpjegohet kontrolli gjyqësor i ligjshmërisë së akteve administrative përfundimtare –kontrolli i ushtrimit të veprimtarisë administrative dhe i shërbimeve publike.

- **Metodologjia e Hulumtimit**

Studentët do të jenë në gjendje: Të zbatojnë metodat kryesore kërkimore juridike dhe të tjera. Të grumbullojnë në mënyrë kritike dhe krijuese materialet kërkimore që janë të rëndësishme dhe të cituara nga autorët në mënyrë

selektive në përgjigjet e tyre; Të kuptojnë fushëveprimin e procesit të kërkimit dhe qasjen e metodave të ndryshme të kërkimit shkencor dhe të jenë në gjendje të kritikojnë ato; Të studiohet përmes një qasjeje të avancuar marrëdhënia midis teorisë juridike dhe praktikës kërkimore; Të zbatojnë aftësitë dhe njohuritë që kanë fituar përmes tezave të tyre; Si të shmangjet plagjiatura; Të kenë njohuri të avancuara për metodat e kërkimit në shkencat juridike si dhe standardet e citimit.

- **Punimi i magjistraturës**

Kjo lëndë u mundëson studentëve t'i bartin shkathtësitë dhe dituritë e tyre për hulumtimin dhe hartimin e detyrës më të komplikuar - shkrimin të punimit të magjistraturës. Lënda është paraparë që tërësisht të jetë praktike dhe studentët t'i fitojnë dituritë dhe aftësitë, shkathtësitë dhe besimin e nevojshëm që t'i qasen hulumtimit dhe shkrimin të tezës. Lënda ka vetëm një rezultat kthyes – t'u mundësojë studentëve ta shkruajnë tezën e magjistraturës me vështirësi minimale dhe me efektivitet maksimal. Gjithçka që është paraparë të bëhet ka për qëllim përmirësimin e teknikave të hulumtimit dhe të stilit të shkrimin të tezës së magjistraturës duke pasur kujdes me këtë rast për ndalimin e shërbimit me mjetet e palejueshme siç janë: plagjiatura dhe shkelja e të drejtave të autorit, që ndalohen me Statutin e UEJL-së.

Lëndë zgjedhore

- **E drejta e vetadministrimit lokal**

Qëllimi kryesor i lëndës është të analizojë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe kritike fenomenin e vetëqeverisjes lokale, si kategori themelore juridike e demokracisë dhe integritit bashkëkohor evropian, përmes prizmit të tendencave bashkëkohore të globalizimit; si një kundërpeshë e nevojshme dhe efektive ndaj pushtetit qendror; si një parakusht i domosdoshëm për një sistem politik funksional; si shkolla më e mirë për qeverisje të mirë dhe demokraci. Lënda ofron informacione dhe njohuri të reja për zbatimin e menaxhimit në vetëqeverisjen lokale. Përmes këtij projekti nxënësit: - Ata do të fitojnë njohuri specifike për konceptet organizative dhe funksionale të qeverisjes vendore. - Do të fitojnë njohuri për funksionimin e vetëqeverisjes lokale dhe financimin e saj, ndarjen e pushtetit dhe marrëdhëniet ndërmjet vetëqeverisjes lokale dhe pushtetit qendror. - Ata do të fitojnë njohuri dhe aftësi të nevojshme për menaxhim të mirë duke përdorur modele dhe qasje nga teoria moderne e menaxhimit. - Ata do të jenë në gjendje t'i kuptojnë më mirë problemet që lidhen me funksionimin e vetëqeverisjes lokale dhe do të mund t'i zgjidhin këto probleme dhe t'i zbatojnë vendimet e marra me efikasitet. - Studentët do të zhvillojnë aftësi organizative dhe drejtuese për punë në administratën lokale.

- **Teoria dhe Praktika e Federalizmit**

Kjo lëndë mbulon njohuri për organizimin e shteteve federale, organet e tyre, kompetencat, llojet e shteteve komplekse, disa nga federatat më karakteristike në botë, si dhe çështjet qendrore teorike dhe praktike që lidhen me shtetet federale, si: kushtetuta e shtetit federal, përbërja-struktura e federatës, ndarja e kompetencave ndërmjet subjekteve të federatës, subjektit të pjesëmarrjes së saj dhe organizimi i subjekteve të federatës, çështja e sovranitetit (shtetësisë) në shtetin federativ, perspektivat e federalizmit në botë, si dhe çështja e pozitës së njërive federale në marrëdhëniet ndërkombëtare. Studenti fiton njohuri për konceptet dhe ligjet bazë të federalizmit, të cilat do t'i mundësojnë të thellojë kuptimin historik, krahasues dhe kritik të federatave dhe proceseve aktuale.

- **E drejta kushtetuese e krahasuar**

Në kuadrin e së drejtës kushtetuese të krahasuar, studiohen aspektet krahasuese të sistemeve kushtetuese të vendeve të BE-së dhe më gjerë për të dhënë njohuri të thelluara të parimeve dhe funksionimit të institucioneve kyçe të pushtetit shtetëror nga një këndvështrim krahasues.

- **Gjyqësori kushtetues**

Qëllimi i lëndës është të fitohen njohuri për shfaqjen, zhvillimin dhe format e kontrollit kushtetues-gjyqësor të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, për gjyqësorin kushtetues, me theks të veçantë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe praktikën e saj.

- **E drejta parlamentare**

Qëllimi i lëndës është fitimi i njohurive teorike - juridike dhe praktike - aplikative për parlamentin si organ përfaqësues, legjislativ dhe sovran shtetëror në kuadrin të pushtetit shtetëror në një shtet të caktuar, duke përfshirë organizimin, strukturën dhe kompetencën e tij në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të shoqëruara me aspekte juridike krahasuese.

- **E Drejta Gjyqësore**

E drejta gjyqësore si disiplinë e aplikuar shkencore-juridike fokusohet në aspektin institucional të drejtësisë, më

saktësisht në gjyqësor, i cili synon t'u ofrojë studentëve të drejtësisë njohuri teorike dhe praktike shkencore-profesionale juridike lidhur me: - normat ligjore për organizimin, funksionet dhe kompetencat e gjykatës dhe të organeve e institucioneve të tjera publike që marrin pjesë në procedurën gjyqësore për zbatimin e ligjit; - mbrojtja gjyqësore e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe realizimi i drejtësisë si vlera juridike themelore dhe universale; - normat juridike për procedurat gjyqësore; - normat juridike materiale që zbaton gjykata në procedurën gjyqësore.